

VENDIM
Nr. 603, datë 25.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 17.12.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË
ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, SI DHE PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR
PËRGATITJEN, PROPOZIMIN, KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E
ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 2, 21, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, të ndryshuar, pikat 29/1, 29/2, 29/3 dhe 29/4 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe ministritë e linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku